



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE PËR SHERBIME

Me negociim

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositesit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

GRUPI I OE “INTEGRA Consulting” & NSH INSTITUTE FOR ENTREPR. AND SMALL BUSINESS nga Prishtina, Komuna e Prishtinës, me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 810830316 të cilat i përfaqëson, z. Ali Lushi “kryersi i shërbimeve”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:

VLERËSIMI I DËMËVE TE SHKAKTUARA GJAT KOHËS SË PANDEMISË TË KRIJUARA SI REZULTAT I KORONA VIRUSIT COVID-19

Nr. I prokurimit	633-20 - 4114 -2-2-5/ C/370
Nr. I brendshëm	633 / 020/ 055-2-2-5

Neni 1 Lënda e kësaj kontrate është kryerja e shërbimeve si në vijim:

VLERËSIMI I DËMËVE TE SHKAKTUARA GJAT KOHËS SË PANDEMISË TË KRIJUARA SI REZULTAT I KORONA VIRUSIT COVID-19 ne Komunen e Istogut, mbledhja dhe perpunimi i të dhënave ekonomike me qëllim te vlerësimit te dëmit ekonomik te shkaktuar nga pandemia COVID-19 ne Komunen e Istogut dhe nxjerrja e rekomandimeve per masat sanuese per rimekembjen e ekonomise pas pandemise ne komunen tone.

Neni 2 Afati i fillimit dhe perfundimit të shërbimeve

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e të gjitha SHËRBIMEVE do të jetë: **08.11.2020** si afat I skadimit te afatit te kontratës.

2.2 Vendi i kryerjës së shërbimeve do të jenë KOMUNA E ISTOGUT –

2.3. Obligimet e kontraktorit (kryersit te shërbimit) janë te gjitha sherbimet të percaktuara ne Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve te pergjithshme dhe te veqanta te kontratës.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi I kontratës për të gjitha shërbimet e kryera është **15.000,00 dhe me shkronja “Pesëmbëdhjetëmijëeuro”**

3.2 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës pas dorezimit te raportit perfundimtar te kryerjës së sherbimeve.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike për sherbime
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.




5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për kryesin e shërbimeve:

GRUPI I OE "INTEGRA Consulting" & NSH "INSTIT. FOR ENTREPR. AND SMALL BUSINESS"

Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri:	<i>Ali Lushi</i>
Pozita:	<i>Zyrtar përgjegjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>L i d e r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>09.10.2020</i>	Data:	<i>09.10.2020</i>
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>[shëno emrin, adresen e menaxherit të Projektit]</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <i>[është 10% i vlerës së kontratës.</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	n/a
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:</p> <p>a) vendim nga gjyqi; ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.</p> <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr.	Titulli	Prodhuesit model	Vendi i origjinës	Shënim	Nësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera
1.	VLERSIMI I DEMEVE TE SHKAKTUARA GJATE KOHES SE PANDEMISE TE KRIJUAR SI REZULTAT O KORONA VIRUSIT COVID-19 VLERSIMI I DEMEVE TE SHKAKTUARA GJATE KOHES SE PANDEMISE TE KRIJUAR SI REZULTAT I KORONA VIRUSIT COVID-19			Integra Consulting & IESB	VLERSIM	1,00	16 995,00	16 995,00
							ÇMIMI	16 995,00
							TOTALI TVSh	0,00
							TOTALI	16 995,00